



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 141 Datë 04.11.2020

“ Për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor.”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në zbatim të VKM - s Nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipa listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” Shtojca 6, bazuar në kërkesën e shoqërisë “HIDRO ONE ENERGY” sh.p.k, me Nr.39 Prot.Tiranë më 28.10.2019, protokolluar pranë bashkisë sonë me Nr.4934 Prot. date 29.10.2019 për heqjen/marrjen në përdorim nga fondi pyjor publik të sipërfaqes që do të përdoret për ndërtimin e Hidrocentraleve “Dohoshisht 2 & 3”, Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, vendosi me datë 04.11.2020 me 19 vota pro 0 vota kundër 0 vota apstenim.

VENDOSI :

1. Të miratojë heqjen nga fondi pyjor publik të sipërfaqes pyjore prej **0.1310 ha** (zero pikë një mijë e treqind e dhjetë ha) ose **1 310 m<sup>2</sup>** ( një mijë e treqind e dhjetë m<sup>2</sup> ) si edhe dhënien në përdorim me qira të sipërfaqes pyjore prej **0.1431 ha** (zero pikë një mijë e katërqind e tridhjetë e një ha) ose **1 431 m<sup>2</sup>** (një mijë e katërqind e tridhjetë e një m<sup>2</sup> ), ngastrat nr.136/b dhe 137/b të ekonomisë pyjore Deshat Maqellarë të kërkuar nga shoqëria “HIDRO ONE ENERGY” sh.p.k për ndërtimin e Hidrocentraleve “Dohoshisht 2 & 3”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave në Bashki.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Dibër.

